



Përmbledhje

MAGIC ICE, është kompani vendore me përvojë shumëvjeçare në industrinë e ushqimit të gjithë të interesuarit që duan të jenë pjesë e MAGIC ICE, ftohen që të aplikojnë për pozitat e hapura të punës:

I. Financier / Kontabilist

LOKACIONI: MAGIC ICE Zona Industriale Lipjan.

ÇKA OFRON MAGIC ICE :

- Ndërmarrje profesionale dhe dinamike;
- Ambient profesional dhe motivues;
- Kompensim sipas aftësive dhe rezultateve të arritura;
- Mundësi të përparimit të karrierës.

ÇKA PRESIM NGA KANDIDATËT:

- Qasje me përgjegjësi dhe përkushtim të lartë në punë;
- Të jenë të motivuar për punë;
- Kandidatë që shprehin iniciativë dhe aftësi të punojnë të pavarur dhe nën presion.

II. PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT PËR PORZITËN:

Kontabilist/e, Administrator/e Intern/e i/e Çertifikuar

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes për kontabilist/e.

- Të ketë Diplomë Universitare të Fakultetit Ekonomik;
- Të jetë kontabilist/e i/e çertifikuar; (preferuara)
- Përvojë pune së paku 2 vjeçare në fushën e financave (Ta ketë të dëshmuar me referencë); e preferuar
- Aftësi në organizimin dhe menaxhimin e punës
- Njohja e programit të kontabilitetit PRO-DATA e domosdoshme;
- Shkathtësi të larta në përdorimin e moduleve të MS Office (Veçanërisht Excel)

- Njohja e gjuhës Angleze – e domosdoshme
- Certifikata e SCAAK konsiderohet përparësi.
- Zotësi të mira në shkrimin e raporteve të ndryshme për punë;
- Zotësi të mira komunikimi me klientët;
- I/e gatshme për të përvetësuar vazhdimisht njohuri e shkathtësi të reja në punë;
- I/e gatshme për vizita në teren;
- Të ketë aftësi të mira në shkrimin e raporteve të ndryshme për punë.

Detyrat e punës për pozitën:

- Regjistron transaksionet ditore në sistemin e kontabilitetit;
- Regjistrimet në kontabilitet, respektivisht faturat shitëse, blerëse, shpenzime, etj;
- Regjistrimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave në kontabilitet;
- Regjistrimin dhe llogari-mbajtjen e të dhënave për shitje, blerje, shpenzime, borxhe etj;
- Përfaqësimin e biznesit para institucioneve financiare kur kërkohet nga punëdhënësi;
- Ndhmon në përpunimin e pasqyrave financiare dhe raporteve të brendshme për klientët specifik;
- Pranimin dhe dorëzimin e porosive nga klientët;
- Përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore, analizën e tyre;
- Raporte të klientëve, analitikë e klientëve, raporte dhe analitikë për produkte;
- Punë të kontabilitetit;
- Menaxhimin e pagesave më arkë;
- Prezentimi i biznesit nëse kërkohet nga kompania;
- Punë administrative;
- Punë të tjera në lëmin e Financave dhe të kontabilitetit më interes për kompaninë.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Diploma e Universitetit;
- Certifikatë Kontabiliteti e preferuar
- Kopja e letërnjoftimit;
- Vërtetimi/Referencë e përvojës së punës (Duke përfshirë Nr. kontaktues);
- Letër motivuese;
- CV.

Procedura e Aplikimit:

Të interesuarit mund të dërgojnë CV-në e tyre në: konkurs@magicice.net ose për informim ne tel: ne **049/125-605**, nga ora 10 deri në ora 15, e Hënë deri të Enjten, kurse vetëm kandidatët që hyjnë në rrethin e ngushtë do të njoftohen dhe ftohen në intervistë. Konkursi është i hapur deri më: **27/01/2021**.